



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Filozofi

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë varianti A	B	D	C	B	A	D	A	D	A	B

Pyetjet me zhvillim

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje

- Çdo substancë është subjekt i përbërë nga materia dhe forma.
- Nuk ka materie pa formë dhe formë pa materie.
- Midis tyre, rolin kryesor e luan materia/është parësore/mbartëse e formës.
- Aristoteli e zgjidhi në mënyrë materialiste problemin themelor të filozofisë.
- Në trupin njerëzor është shpirti ai që shërben si motor i palëvizshëm.
- Shpirti është forma substanciale që vë në lëvizje materien.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre tipare të parimit të kërkuar;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy tipare të parimit të kërkuar;

1 pikë Nëse shkruan një tipar të parimit të kërkuar;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Përvoja shqisore është themeli i njohjes.
- Kriteri i së vërtetës për Epikurin përbëhet nga ndijimet, pararendëset /konceptet e përgjithshme dhe emocionet. ndijimi konceptohet si kontakt fizik.
- Ai prodhohet nga rrjedha e atomeve që dalin nga sipërfaqja e sendeve.
- Ato kanë pamje, “figura të vogla” të objekteve, që “godasin” organet tona të shqisave.
- Shqisat, në këtë mënyrë realizojnë një farë regjistrimi” të objekteve.
- Por, përfytyrimi i sendit është i mundur edhe në mungesë të tij.
- Ndijimet e mëparshme të përsëritura mbeten te njeriu si kujtesë.
- Përvoja e mëparshme lë gjurmë tek ai e kjo mundëson një njohje paraprake të objekteve, edhe kur ato nuk janë përballë nesh.
- Ndaj Epikuri i quan ato pararendëse, përfytyrime mendore të sendeve ose koncepteve që i paraprijnë përvojës së re.
- Për Epikurin, ndijimi është gjithnjë i vërtetë.
- Por, kur ndodh gabimi, siç e dëshmon përvoja?
- Rremat, p.sh., në sipërfaqen e ujit duken të përthyerë; kur nga alg shohim një person që mendojmë se është një miku ynë- nga afër zbulojmë se nuk është ai.
- Sipas Epikurit gabimi nuk lidhet me ndijimin, por me opinionin, kur ai jepet në mënyrë të panevojshme, pa marrë konfirmimin nga përvoja dhe të dhënat shqisore.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre momente nga logjika e Epikurit;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy momente nga logjika e Epikurit;**1 pikë** Nëse shkruan një moment nga logjika e e Epikurit;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 13** **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Duhet një moral që të harmonizojë virtytin individual dhe politik.
- Ekzistenca njerëzore është një përvojë e vazhdueshme, përherë në ndryshim. Njeriu shqetësohet vazhdimisht për të ardhmen. Ai zotërohet nga ndjenja frike, dëshire dhe shpresa të lidhura me të. Duhet menduar ndryshe.
- Jeta duhet marrë ashtu si vjen/natyrshëm/me të gjitha kontradiktat dhe problemet që mbart. Mençuria njerëzore qëndron kur di të të pranosh edhe të keqen si bashkëudhëtare/kur bashkë me jetën pranon edhe vdekjen si ngjarje natyrore. Njeriu duhet ta pranojë vdekjen që ta vlerësojë jetën e të jetojë më mirë.
- Te kërkimi i një lumturie tokësore qëndron urtësia e njeriut/braktisja e çdo krenarie/mendjemadhësie intelektuale/tolerance ndaj gabimeve njerëzore/.
- Relativizmi kulturor-hedhja poshtë e vlerësimeve përcëmuese të evropianëve, që i quan disa popuj barbar e të egër/ata janë thjesht, të ndryshëm.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse shkruan tre pikëpamje të kërkuara;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy pikëpamje të kërkuara;**1 pikë** Nëse shkruan një pikëpamje të kërkuara;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**3 pikë****Përgjigje**

- Vepra është një mbrojtje e krishterimit dhe historia njerëzore gjykohet nga këndvështrimi teologjik. Dy dashuri kanë ndërtuar dy qytete:
- dashuria për veten, deri në përbuzje të Zotit, ka ndërtuar qytetin tokësor. Dashuria për Zotin, deri në përbuzje të vetes, ka ndërtuar qytetin qiellor, ose të Zotit.
- qyteti tokësor është komuniteti i atyre që jetojnë sipas trupit, mishit, ndërsa ai i Zotit, është i atyre që jetojnë sipas shpirtit. Aty janë të zghedhurit e Zotit;
- Këto qytete dallohen nga vlerat që mbartin komunitetet e tyre/nga qëllimi i dashurisë së tyre.
- Agustini nuk i barazon qytetet me institucionet respective-shteti dhe kisha.
- Shteti nuk ka vlera mbinatyrore/nuk ka të bëjë me shpëtimin tejtokësor, ndërsa kisha është instrument për të ndërtuar qytetin e Zotit;
- Dy qytetet bashkëjetojnë në luftë me njëri-tjetrin.
- Roma qytet tokësor-qyteti i djallit, të pafe, adhures të perëndive të rreme/pagane;
- Fuqizimi dhe shaktërimi i perandorisë është shenjë e një vullneti mbinatyor.

Nxënësi fiton:**3 pikë** Nëse jep në mënyrë krahasuese tre tipare për dy llojet e qyteteve që kërkohen;**OSE****2 pikë** Nëse jep në mënyrë krahasuese dy tipare për dy llojet e qyteteve që kërkohen;**1 pikë** Nëse jep një tipar për dy llojet e qyteteve që kërkohen;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 15****4 pikë****Përgjigje:**

Kjo gjendje:

- tregon se si jetonin individët para do organizimi social;
- është e konceptuar racionalisht, por jo e provuar historikisht;
- mundëson të dallohet kultura nga natyra;
- Shteti nuk është realizim i njeriut, por është një mjet, përmes të cilit njeriu shkëputet nga natyra, një krijim që nuk ka lidhje me fenë. Problemi është si të kuptohen arsyet si të kuptohen arsyet e kalimit nga gjendjea natyrore në gjendjen civile;
- Në gjendjen natyrore(lufta e të gjithëve kundër të gjithëve) sundojnë konfliktet dhe dhuna. Dy parime e karakterizojnë njeriun në gjendjen natyrore:
- njeriu dëshiron të sundojë mbi tjetrin;
- njeriu për njeriun është ujk.
- Të gjithë janë të pasigurtë, kanë frikë nga vdekja e dhunshme dhe instikti i vetëruajtjes e shtyn të mbrojnë jetën e vet. Këtu shpërthen rivaliteti dhe pasiguria e përhershme. Kjo frikë i detyron njerëzit të formojnë shtetin, i nënshtrohen atij në disa drejtime, duke hequr dorë nga disa liri të tyre, që të fitojnë siguri për jetën.

Nxënësi fiton:**4 pikë** Nëse shkruan katër elemente nga teza e kërkuar;**OSE****3pikë** Nëse shkruan tre elemente nga teza e kërkuar ;**2 pikë** Nëse shkruan dy elemente nga teza e kërkuar ;**1 pikë** Nëse shkruan një element nga teza e kërkuar;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Xhon Lok i jep përparësi të drejtave të individit, duke u bazuar në idenë e të drejtave të njeriut.
- Qeveria nuk ka të drejtë të rregullojë jetën private të individëve, sidomos ato që lidhen me fenë.
- Toleranca pozitive është e domosdoshme në çështjet e kultit. Secili duhet ta zgjedhë lirshëm besimin e vet.
- Kjo përforcohet edhe nga baza e filozofisë së tij, që nuk e pranon teorinë e ideve të lindura të vendosura në shpirtin e njeriut nga Zoti.
- Loku kërkon ndarjen e kishës nga shteti.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre aspekte nga tolerance fetare;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte nga tolerance fetare;

1 pikë Nëse shkruan një aspekte nga tolerance fetare;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ligjet që krijohen nga pushteti, që të jenë të drejta, duhet të përputhen me ligjet natyrore, të përjetshme.
- E drejta natyrore përbën parimin bazë të ligjeve positive dhe normën universal për vlerësimin e tyre.
- Ligji në përgjithësi është arsyeja njerëzore, siç ai qeveris të gjithë popujt e tokës.
- Sipas tij, ka një drejtësi ideale, para çdo drejtësie të krijuar nga njerëzit, bazuar mbi natyrën njerëzore.
- Ligjet pozitive “duhet të jenë aq të përshtatshme për popullin për të cilin bëhen, sa do të jetë një rast i madh nëse ato të një kombi t’i shkojnë një kombi tjetër.”
- Monteskjë përpunon një konceptim determinist të ligjeve. Ligjet pozitive ndryshojnë nga një shtet të tjetri.
- Monteskjë i gjen arsyet në klimën, natyrën dhe regjimet e ndryshme politike, por edhe te shpirti i popujve, zakonet, mënyrat e jetesës, etj.
- Zakoni është një ligj i pashkruar që i jep kuptim dhe vlerë ligjit pozitiv-rregullave që nxjerr shteti.
- Por ligji nuk është thjesht produkt i zakoneve dhe këto nuk janë të mjaftueshme për të bërë të drejtën.
- Ligji civil dhe kushtetuta supozojnë vullnetin e një legjislatori dhe nuk janë thjesht, pasqyrim i thjeshtë i zakoneve.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse liston tre momente nga racionaliteti i ligjit për autorin e kërkuar;

OSE

2 pikë Nëse liston dy momente nga racionaliteti i ligjit për autorin e kërkuar;

1 pikë Nëse liston një moment nga racionaliteti i ligjit për autorin e kërkuar;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **2 pikë****Përgjigje:**

- a) kritikon disa shkrime të historisë për pasaktësi;
- b) historia- rrjedha e bëmave të bujshme dhe e mrekullive të mbretërve;

c) në histori nuk merret parasysh roli i njerëve të zakonshëm.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shkruan dy mendime/qëndrime të autorit

OSE

1 pikë Nëse shkruan një mendim të autorit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19

3 pikë

Përgjigje:

- Historia nuk është një kaos i pakuptueshëm, por është realizim i shpirtit, i cili shpaloet përmes modelit kulturor sundues të një epoke.
- “Historia universale është vetë shfaqja e arsyes.”
- Shpirti mishërohet në veprat e qytetërimit: Arti, feja dhe filozofia janë fushat e shpalosjes progressive të shpirtit.
- Ka një kuptim dhe një qëllim të historisë.
- Historia ecën në mënyrë progresive.
- Në qoftë se në dukje historian a ngjan aq kaotike, kjo ndodh sepse ne nuk e kapim lëvizjen dialektike që i jep jetë idesë që realizohet në histori.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre tipare të filozofisë së kërkuar;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy tipare të filozofisë së kërkuar;

1 pikë Nëse shkruan një tipar të filozofisë së kërkuar;

OSE

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20

3 pikë

- Pse themi se “Koha kalon dhe nuk përmendim se ajo edhe vjen”. Hajdegeri na bën të vetëdijshëm për një përmasë tjetër tonën: atë të përkohshmërisë në botë.
- Duke u përpjekur të lërë gjurmë në këtë botë, njeriu mund të bjerë në gjendje shpirtërore ankthi. Vetë mundësitë që ai ka në jetë dhe fakti që duhet të zgjedhë midis tyre, shkakton ankth.
- Ankthi nuk ka të bëjë me frikën konkrete nga një diçka (sikurse edhe te Kirkegardi).
- Ankthi vjen nga ekzistenca e njeriut në botë dhe është veçori vetëm për njerëzit. Edhe kafsha mund të ketë frikë.
- Ankthi i zbulon njeriut se është një qenie e vogël, e përkohshme në botë dhe e destinuar të vdesë. Ky fat i pashmangshëm shkakton ankth.
- Kjo sepse, qëllimet që i vëmë vetes në jetë mund të na duken të kota; sepse jemi të kufizuar në hapësirë dhe kohë dhe nuk mund të ndjekim një profesion, sepse duam të jemi sa më të mirë në të.
- Ankthi vjen pasi mund të zgjedhim të bëhemi gazetarë, por pas kësaj zgjedhjeje nuk mund të zgjedhim më të bëhemi mjekë e jeta është e mbushur me zgjedhje të diçkaje dhe heqje dorë prej të tjerave.
- Vetë ky kufizim shkakton ankth.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre momente nga koncepti i kërkuar;

OSE

2 pikë Nëse dy shkruan dy momente nga koncepti i kërkuar;

1 pikë Nëse një shkruan një moment nga koncepti i kërkuar;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.